



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

Nr. 1864 Prot

Tiranë, më 10/11 /2025

URDHËR

Nr. 12, Datë 10/11 /2025

Për miratimin e Planit të monitorimit dhe masave gjatë procesit të licencimit

Në zbatim të Ligjit Nr. 46/2018, "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake, mallrave dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", VKM Nr. 31, datë 22.1.2020 "Për organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe të procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si dhe përcaktimin e procedurave për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror", me qëllim forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes, transparencës dhe efikasitetit gjatë procesit të licencimit,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të monitorimit dhe masave shoqëruese gjatë procesit të licencimit, me synim sigurimin e zbatimit të unifikuar të procedurave, parandalimin e rreziqeve të mospërputhjes dhe garantimin e integritetit institucional, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhëri.
2. Përmbajtja e planit të monitorimit
 - a) Hapat e kontrollit administrativ dhe teknik gjatë shqyrtimit të aplikimeve për licencë;
 - b) Verifikimin e dokumentacionit të paraqitur dhe të dhënave të deklaruara nga subjekti;
 - c) Kryerjen e kontrolleve në vend, sipas rasteve kur vlerësohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse;
 - d) Vlerësimin e riskut për çdo subjekt apo transaksion në bazë të kriterëve të përcaktuara;
 - e) Raportimin periodik të ecurisë së monitorimit dhe masave të marra.
3. Masat gjatë procesit të licencimit
 - a) Zbatimi i parimit të "kontrollit të dyfishtë" në verifikimin e aplikimeve;
 - b) Verifikimi i subjekteve dhe mallrave kundrejt listave ndërkombëtare të sanksioneve (UN, BE, SHBA, etj.);
 - c) Dokumentimi i çdo vendimmarrjeje në sistemin elektronik të licencimit;
 - d) Sigurimi i gjurmueshmërisë së plotë të procesit në çdo fazë;
 - e) Raportimi i menjëhershëm i çdo rasti të dyshuar për shkelje apo parregullsi.
4. Zbatimi i këtij urdhëri i ngarkohet:
 - a) Drejtorisë së Legjislacionit dhe Licensave;
 - b) Drejtorisë së Inspektimit Vlerësimit dhe Analizës;
 - c) Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet gjatë gjithë periudhës së monitorimit të procedurave të licencimit për vitin 2025-2026.

KRYETARI

Andrea SHLLAKU



PLAN MONITORIMI DHE MASASH PËR PROCESIN E LICENCIMIT

Periudha e zbatimit: 2025–2026

Institucioni përgjegjës: Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE)

1. Qëllimi i Planit

Ky plan ka për qëllim sigurimin e një procesi licencimi të qartë, të kontrolluar dhe të përshtatur me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe garantimin e transparencës, integritetit dhe efikasitetit në shqyrtimin, dhënien dhe monitorimin e licencave.

2. Objektivat Kryesore

- Zbatimi i plotë i kërkesave ligjore dhe nënligjore për licencimin.
- Monitorimi i performancës dhe përputhshmërisë së subjekteve të licencuara.
- Identifikimi dhe adresimi i mangësive në procesin e aplikimit dhe shqyrtimit të licencave.
- Garantimi i raportimit periodik dhe transparencës për çdo fazë të procesit.

3. Fushat e Monitorimit

Nr.	Fusha e Monitorimit	Përshkrimi	Frekuenca	Përgjegjës
1	Verifikimi paraprak i dokumentacionit	Kontrolli i plotësisë dhe vlefshmërisë së dokumenteve të paraqitura nga subjektet. Pergatitja e nje liste me dokumentacionin qe permban dosja	Çdo aplikim	Spektori i Regjistrat dhe licensave
2	Vlerësimi ligjor	Analiza e përputhshmërisë me kriteret ligjore	Çdo aplikim	Spektori i Legjislacionit dhe Perfaqësimit
3	Vlerësimi teknik	Analiza e përputhshmërisë	Çdo aplikim	Spektori i Inspektimit

		me kriteret teknike		
4	Vleresimi i paleve te perfshira ne transaksion (subjekte dhe shtete)	Verifikimi i te gjithë paleve te perfshira ne transaksion perms databazeve te rriskut dhe sanksioneve.	Çdo aplikim	Sektori i Analizës dhe Vlerësimit
5	Propozimi për licencim	Evidentimi i arsytimit ligjor dhe dokumentimi i procesit të vendimmarrjes	Çdo rast	Drejtori I Drejtorise së Legjislacionit dhe Licensave dhe Drejtori I Drejtorisë së Inspektimit, Vlerësimit dhe Analizës
6	Vendimarrja për Licensim	Miratimi I procesit dhe pajisja me licensë	Çdo rast	Kryetari
7	Monitorimi pas licencimit	Kontrolli i respektimit të kushteve të licensës	1–2 herë në vit	Drejtoria e Inspektimit, Vlerësimit dhe Analizës
8	Trajtimi i ankesave	Monitorimi i rasteve të shkeljeve dhe masave të ndërmarra	Tremujor	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licensave
9	Procesi i punes ne cdo sektor	Raportim javor mbi prosesin e punes se secilit sektor	Cdo te premte	Pergjegjesit e sektoreve

4. Masat e Planifikuara për Përmirësim

Nr.	Masa	Përshkrimi	Afati	Përgjegjës
1	Hartimi i manualit të brendshëm të licencimit	Standardizimi i procedurave dhe formularëve	Dhjetor 2025	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licensave
2	Përditësimi i sistemit elektronik të aplikimeve	Përcjellja pranë AKSHI të formateve të standartizuara të aplikimeve	Dhjetor 2025	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licensave dhe Drejtoria e Inspektimit, Vlerësimit dhe Analizës
3	Trajnim për stafin	Përgatitja e planit të përmbledhur mbi trajnimin e stafit me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale mbi kriteret ligjore dhe teknike	Janar 2026	DDLL+ DDAVI Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
4	Hartimi i check-list për kontrollet	Lehtësimi i procesit të inspektimeve pas licencimit	Shkurt 2026	Drejtoria e Inspektimit, Vlerësimit dhe Analizës
5	Rishikimi i tarifave të licencimit	Sigurimi i mbulimit të kostove administrative	Qershor 2026	Drejtoria Legjislacionit dhe Licensave

5. Indikatorët e Monitorimit

Nr.	Indikator	Njësia matëse	Burimi i të dhënave	Objektivi

1	Koha mesatare e shqyrtimit të aplikimeve	Ditë pune	Regjistri i aplikimeve	≤ 20 ditë
2	Numri i aplikimeve të kthyera për plotësim	% e totalit	Raportet e licencimit	$\leq 15\%$
3	Numri i kontrolleve pas licencimit	Nr. kontrolle	Raportet e inspektimit	$\geq 80\%$ të planifikuara
4	Numri i shkeljeve të konstatuara	Nr. raste	Raportet vjetore	Ulje krahasuar me vitin paraprak

6. Mekanizmat e Raportimit dhe Ndjekjes

- Raport mujor për aplikimet, shqyrtimet dhe vendimmarrjet;
- Raport tremujor për monitorimin e subjekteve dhe masat administrative;
- Raport vjetor për analizën e performancës së procesit të licencimit;
- Mbledhje periodike të grupit të punës për analizën e ecursë së zbatimit të planit.

7. Përfundime

Zbatimi i këtij plani garanton një proces të standardizuar, të verifikueshëm dhe transparent të licencimit, duke rritur efikasitetin administrativ dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi.